

Tiranë, më _____.____. 2026

Lënda: Dërgim informacioni

Znj. Sabina Nika

MCN TV

Adresa: Rruga është te Rruga e Vilave, Lundër (Farkë), Tiranë

Pasi u njohëm me kërkesën tuaj për informacion, datë 12 gusht 2026, dërguar elektronikisht në adresën tonë me lëndë “Kërkesë për informacion”, referuar Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku kërkonti info mbi TEC-et lundruese në Vlorë ("Tigri 1" dhe "Tigri 2/3"), sqarojmë si më poshtë:

1. *Sa është sasia totale e energjisë elektrike (e matur në MWh) e prodhuar efektivisht nga dy TEC-et lundruese në Vlorë ("Tigri 1" dhe "Tigri 2/3") që nga çasti i ndezjes së tyre e deri më sot, dhe sa ditë kanë qenë ato në gjendje aktive prodhimi?*

Dy TEC-et lundruese në Vlorë, “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, kanë qenë në dispozicion të sistemit për aktivizim sipas nevojave të prodhimit dhe të kërkesës së sistemit energjetik.

Aktivizimi i tyre është kryer në funksion të nevojave të sistemit dhe, për rrjedhojë, ato nuk kanë operuar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë periudhës së disponibilitetit.

Sasia totale e energjisë elektrike e prodhuar efektivisht nga këto TEC-e, nga momenti i vënies në funksionim deri më datën e dhënies së këtij informacioni, është 109,125.55 MWh. Gjatë kësaj periudhe (shtator 2024 - 12 gusht 2026), orët efektive të punës (prodhimit) të këtyre TEC-eve kanë qenë rreth 1,392 orë. Për sa i përket periudhës së operimit, TEC-et kanë qenë në dispozicion gjatë gjithë periudhës, ndërsa prodhimi efektiv është realizuar në varësi të nevojave dhe kërkesave të sistemit energjetik.

2. *Sa ton lëndë djegëse (naftë e rëndë/mazut ose HFO) janë konsumuar gjithsej për këtë prodhim dhe sa ka kushtuar financiarisht blerja dhe transporti i këtij karburanti për t'u përdorur posaçërisht tek këto anije?*

Sasia totale e lëndës djegëse (naftë e rëndë/mazut ose HFO) të konsumuar për këtë prodhim është 25,358.33 ton.

Vlera totale e blerjes së lëndës djegëse të konsumuar për këtë prodhim është 1,546,810,307 lekë (kosto blerje furnitori + akcizë e pa rimbursueshme + taksa doganore + agjensi doganore), dhe Kostoja e transportit është 9,870,696 lekë (450 lekë/ton).

3. Sa është vlera totale e pagesave të kryera nga KESH deri më tani për qiranë ditore të anijeve, mirëmbajtjen, siguracionin dhe shërbimet e ankorimit, dhe sa është kostoja finale e përlogaritur për çdo megavat/orë (1 Mwh) të prodhuar prej tyre?

- Vlera totale e pagesave të kryera nga KESH për qiranë është 44,131,011 usd
- Vlera totale e shpenzimeve deri më tani për mirëmbajtjen është 21,010,500 usd.
- Vlera totale e shpenzimeve deri më tani për siguracionin është 347,573,851 lekë.
- Vlera totale e shpenzimeve deri më tani për shërbimet e ankorimit është 0 lekë/euro.
- Kostoja e përlogaritur për MW/orë (1 MWh) të prodhuar nga këto anije është 163 euro/MWh.